

Sqarim për media

Tiranë, më 15 Janar 2020: Duke u nisur nga disa artikuj dhe lajme në media referuar një studim të OKB dhe projeksionit me disa skenarë mbi popullsinë shqiptare, vlerësimet e të cilit në disa raste janë kombinuar me të dhëna të pasakta, burimi i të cilave thuhet të jetë INSTAT, duhet të sqarojmë se:

Duke qenë se migracioni është një fenomen dinamik, që do të thotë se të larguarit e një viti janë potencial për migracion kthimi gjatë një viti të mëpasshëm, sikundër mund të jenë imigrantët potencial për emigrim sërish në vitet në vijim. Në këtë mënyrë, **nuk mund të mblidhen numrat e estimuar të emigrantëve / imigrantëve gjatë viteve, në këtë rast 2011-2018, pasi ky total numëron të njëjtin person disa herë.**

Definicioni bazë në linjë me regulloret e Eurostat mbi të cilin INSTAT bazohet për llogaritjen e popullsisë banuese është ai i **Vendbanuesit të Zakonshëm**. (referoju - [Regulation \(EU\) No 1260/2013 of the European Parliament and of the Council of 20 November 2013 on European demographic statistics](#) si dhe [Regulation \(EC\) No 862/2007 of the European Parliament and of the Council of 11 July 2007 on Community statistics on migration and international protection and repealing Council Regulation \(EEC\) No 311/76 on the compilation of statistics on foreign workers, OJ L 199, 31.7.2007, p. 23-29](#)).

Vendbanues i zakonshëm: Vendbanuesit e zakonshëm janë të gjithë personat të cilët janë banues të zakonshëm në Shqipëri, pavarësisht shtetësisë së tyre

Numri i Emigrantëve në vitin 2018 është 38.703 duke përsuar një rënie me 3 % krahasuar me një vit më parë. Po të shikojmë trendin gjatë periudhës 2011-2018 numri i emigrantëve ka pësuar rënie. Po të krahasojmë numrin e emigrantëve në vitet 2011 viti i censit të fundit të popullsisë me vitin 2018, rezulton se ka një rënie të këtij numri me 30%.

Nga ana tjetër, numri i imigrantëve (shqiptarë që kthehen në vend) në vitin 2018 është 23.673 banorë, duke pësuar një rënie me 5,3 % krahasuar me një vit më parë.

Gjatë periudhës 2011-2015, numri i imigrantëve ka pësuar rënie dhe në vitin 2015 kemi numrin më të ulët të imigrantëve. Në vitet 2016 dhe 2017 numri i imigrantëve ka pësuar rritje vjetore me 10,6% dhe 8,4%.

15/01/2020

Në vitin 2015, migracioni neto (të ardhurit – të ikurit) ka qenë -20.600, ndërkohë në vitin 2018 kjo shifër ka rënë në -15.030, duke reflektuar një trend rënës gjatë gjithë këtyre viteve.

INSTAT përdor metoda indirekte për llogaritjen e stokut të migracionit ndërsa për vlerësimin e flukseve vjetore përdoren module specifike në anketat pranë familjeve. Këto module janë të mirë konceptuar dhe ndërtohen bazuar në definicionin e Vendbanues i zakonshëm në mënyrë që të mund të vlerësohet numri i emigrantëve dhe imigrantëve në një vit të caktuar.

Ju lutem këtë sqarim ta publikoni në median tuaj si qëndrim zyrtar të INSTAT ndaj këtyre artikujve.